




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



DIREKTORAT POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA DREJTORIA E BUJQESISE, PYLLTARISE DHE ZHILLIMET RURAL

Në bazë të planit të punës për vitin 2026, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për aplikim në subvencionimin e fermerëve për motokultivatorë dhe makina bujqësore.

Kriteret që duhet t'i plotësojë një fermer për të aplikuar për subvencione:

1. Të posedojë letërnjoftim të vlefshëm,
2. Të jetë banor i Komunës së Novobërdës,
3. Të posedojë më shumë se dy (2) ha tokë për kultivimin e drithërave, për përfitim të makinës bujqësore,
4. Të posedojë më shumë se 0.50 ha sipërfaqe me livadhe, për përfitim të makinës bujqësore,
5. Të posedojë më shumë se 0.50 ha sipërfaqe me pemëtore, për përfitim të makinës bujqësore,
6. Të posedojë më shumë se 0.50 ha sipërfaqe me perime, për përfitim të makinës bujqësore,
7. Të posedojë traktor, për përfitim të makinës bujqësore në fushën e bujqësisë dhe pemëtarisë,
8. Të deklarojë përfitimin e subvencioneve nga Komuna e Novobërdës, DBPZHR nga viti 2023 deri më 2025, dhe cilat makina janë përfituar,
9. Përparësi kanë fermerët që nuk kanë përfituar makina bujqësore nga viti 2023 deri më 2025 nga Komuna e Novobërdës, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR),
10. Dorëzimi i aplikacionit dhe dokumentacionit përcjellës brenda afatit kohor të përcaktuar me thirrjen publike,
11. Nënshkrimi i kontratës me drejtorinë gjatë përfitimit të subvencionit (makinës bujqësore).

Subvencioni mbulohet me 70% nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa pjesëmarrja e fermerit është 30% e vlerës së makinës bujqësore të përfituar. Ndërsa për multikultivatorët, subvencioni mbulohet me 80% nga drejtoria, kurse pjesëmarrja e fermerit do të jetë 20%.

Afati për aplikim është nga 25.05.2025 deri më 26.06.2025.

Aplikacionet dorëzohen në zyrën nr. __, në objektin e Komunës së Novobërdës.

NUMRI I PËRFITUESVE ËSHTË I KUFIZUAR.

Novobërdë
Data: 21.05.2026



Saša Milošević
Kryetar i Komunës

Saša Milošević

Dokumentet e nevojshme:

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. Vërtetimi për pagesën e tatimit në pronë, i lëshuar nga Komuna e Novobërdës,
3. Vërtetimi i regjistrimit të fermerit – NIF,
4. Fletëposedimi në emër të aplikuesit. Nëse aplikuesi nuk ka pronë në emrin e tij, nevojitet dëshmi për lidhje farefisnore (certifikata e lindjes).
5. Kontrata për marrjen me qira të tokës. Kontrata duhet të jetë e noterizuar.
6. Dëshmi për posedimin e traktorit,
7. Deklaratë për bashkësi familjare.

Vërejtje:

Fermerët që kanë aplikuar në Thirrjen Publike në vitin 2025 obligohen të rinovojnë dokumentacionin në vijim:

1. Kërkesën për ndarjen e mekanizimit bujqësor.
2. Vërtetimin për pagesën e tatimit në pronë, të lëshuar nga Komuna e Novobërdës.
3. Fletëposedimin në emër të aplikuesit; nëse aplikuesi nuk ka pronë në emrin e tij, nevojitet dëshmi për lidhje farefisnore (certifikata e lindjes).